



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 75/12
Prishtinë, më 28.08.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Duda Balje, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi.

Mungoi: Naser Osmani.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli. Kushtrim Aliu dhe Albulena Gashi Praktikant

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ramadan Avdiu zv/Ministër i Financave, Bajram Rexhepi MPB, Blerim Rexha nga MPB, Isa Elshani, Teuta Luboteni dhe Mevlyde Beqiri nga MTI, Sami Kurteshi Avokat i Popullit, Shqipe Mala, Beqir Misini, Jashar Kastrati nga IAP, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga OSCE, KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur të komisionit dt. 04.07.2012, 05.07.2012 dhe 10.07.2012;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-203 për Metrologji, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-126 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-066 për Procedurën Kontestimore, me Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion;**

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-85 për Bujqësinë Organike, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-90 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
9. Shqyrtimi i Projektregullorës së Kuvendit të Republikës së Kosovës me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditë miratohet njëzëri.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur të komisionit dt. 04.07.2012, 05.07.2012 dhe 10.07.2012

Kryetarja konstatoi se procesverbalet miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-203 për Metrologji, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja sa i përket projektligjit nëse e analizojmë deklaratën e Ministrisë së Financave, shohim projektligji ka implikime buxhetore diku prej 80.000 eurove, dhe këto shpenzime nuk janë të parapara në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe nuk janë të përfshira në kuadër të buxhetit. Parashihet shtimi i numrit të punësuarve prej 5 dhe në bazë të analizës të cilës ja kemi bërë dispozitave të projektligjit dhe amendamenteve nuk dihet saktësisht se ku parashihen të shtohen këta të punësuar

Mevlyde Beqiri kërkesat shtesë buxhetore të paraqitura në vlerësim të ndikimit financiar janë bazuar në nevojën e agjensionit për meteorologji për arsye se shumica e laboratorëve që ne i posedojmë si nuk janë funksionale për punën që duhet ta bëjnë dhe kemi të bëjmë me pozita që janë pak më të veçanta dhe nuk mundet çdo zyrtar të kryejë punën për ato pajisje që i posedojmë. Kërkesën shtesë e kemi bërë me kornizë poashtu edhe me qarkoren e parë dhe të dytë njëkohësisht. Dje ishim edhe në dëgjimet buxhetore në Ministrinë e Financave, që me theks të veçant ishte kërkesa që të plotësohen këto vende të punës për qëllimin e caktuar për të funksionalizuar ligjin që pritet të miratohet.

Kryetarja pyeti në cilin nen të ligjit parashihet shtimi i numrit të punëtorëve, çka është shtuar diçka e re me plotësim-ndryshimet e këtij projektligji që keni kërkuar 5 punëtor, apo deklaratën e keni bërë vetëm ta bëjmë një deklaratë ta shtojmë një numër të të punësuarve ndërsa faktikisht nuk është e paraparë në ligj?

Teuta Luboteni ekziston departamenti i meteorologjisë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, por laboratorët ekzistuese nuk janë funksional ndërsa deri tash kanë pasur donacion prej bashkësisë evropiane. Janë pajisjet por nuk mund ti përdorin pa zyrtar.

Hykmete Bajrami me vet faktin që është proceduar plotësim-ndryshim i ligji është vlerësuar nevoja për përmirësimin e situatës, do të thotë se laboratorët ekzistues duhet funksionalizuar. Ministria duhet të shikojë të bëjë rregullime të brendshme. Ministria që është edhe zv/kryeministre mundet të gjitha kërkesat e saj me i realizu ne Qeveri. Ajo mundet me zvogëluar buxhetin që po i bënë reklamata në CNN e lloj lloj skandale. Ne duhet të bëjmë planifikime më të arsyeshme ta zvogëlojmë buxhetin e reklamave se fundi

kurfarrë beneficione deri tani nuk kemi pasur prej atyre. Me të vërtetë ne po gjindemi në një situatë shumë të keqe, kemi ardhur do të thotë në një situatën ku qeveria nuk i ka 80 000 euro për zbatimin e një ligji. Seriozisht kjo punë nuk ka seriozitet për tu diskutuar në parlament për gjëra të tilla, mua po më duket shumë e ulët dhe banale.

Muhamet Mustafa pikërisht dua të dijë a ishte ky ligj në programin e legjislacionit të qeverisë, pse nuk keni ju buxhet?

Xhevdet Neziraj unë me sa e kuptova këta i kanë pajisjet më herët dhe me ardhë me kërkesa tash në fund të vitit me kërkuar shtimin numrit të punëtorëve për atë teknologji po më duket e paarsyeshme. Me gjithë dëshirë në përkrahje të kërkesave buxhetore që mund të jenë të arsyeshme, por nuk ka mundësi as ligjore as financiare në këtë kohë dhe ndoshta kishte qenë mirë që me rastin e hartimit dhe përcaktimit të buxhetit të Ministrisë për vitin 2013, të parashihni edhe këto kërkesa.

Sali Asllanaj kemi të bëjmë me një ligj të rëndësishëm por nuk mund të lejojmë improvizime në këtë komision. Unë mendoj që sot ta heqim nga rendi ditës, dhe duhet saktësisht me konsekuenca se si duhet ta zgjidhim në vitin e ardhshëm koston buxhetore.

Kryetarja theksoi se nëse analizojmë projektligjin, nga nenet e tij nuk parashihet ndonjë shtim i numrit të punësuarve dhe nuk mund të vërehet se dispozitat prodhojnë kosto buxhetore shtesë. Meqë projektligji nuk prodhon kosto buxhetore shtesë, është detyrë e Ministrisë që nevojat e veta ti rregullojë në kuadër të buxhetit të vet, psh. lejohen kaq numër të të punësuarve ajo le ti rregullon numrin e punësuarve ku ka nevojë, jo me i lënë pajisjet pa personel.

Sali Asllanaj meqë në projektligj nuk parashihet ndonjë implikim buxhetor, dhe pasi që ndihet nevoja shtesë për buxhet shtesë, është periudha kur bëhen kërkesat buxhetore dhe të parashtrihen me kohë dhe të kërkohet buxheti edhe për pesë punëtorët e kërkuar. E kemi ligjin përpara ta miratojmë në bazë të japim rekomandimin se projektligji nuk përmban implikime shtesë buxhetore dhe tani apo deri në muajin tetor, Ministria përkatëse të përfshijë kërkesa në Ministrinë e Financave në buxhetin e kërkuar për vitin 2013.

Ramadan Avdiu ne e përshëndesim ndryshim e ligjit për meteorologji. Është i krijuar departamenti për meteorologji i cili e mbulon fushën përkatëse dhe ka ndarje buxhetore për vitin 2012 prej 93 930 euro, dhe pavarësisht prej ndryshimit të ligjit Ministria e Financave konsideron që qdo ndikim buxhetor do të duhet të absorbohet brenda për brenda ndarjes buxhetore që e ka Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Nuk ka buxhet të planifikuar as me qarkore të buxhetit të vitit 2013 as në kornizën afatmesme të shpenzimeve kështu që konsiderojmë që do të ketë mundësi që të absorbohet brenda për brenda ndarjes buxhetore që do ta ketë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për vitin e ardhshëm.

Hykmete Bajrami theksoi se është kundër projektligjit, për arsye se na po prodhojmë ligje të pazbatueshme. Në projektligj nuk shkruan që do të rritet numri i punëtorëve por nëse vlerësojmë nevojën për funksionalizimin e laboratorëve shifet se ka nevojë. Laboratorët e Ministrisë së Tregtisë ishin donacion dhe është turp prej donatorëve sepse kanë kushtuar me qindra mijëra euro e sot e kësaj dite askush prej nuk dinë ti përdorë sepse aty ka njerëz që vijnë vetëm kur ti teket.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me Tetë vota Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Sali Asllanaj, Duda Balje, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), një Kundër (Hykmete Bajrami) dhe një Abstenim (Albana Fetoshi), nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-203 për Metrologji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-126 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së

Kryetarja ne e kuptojmë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e miratimit të këtij ligji për shkak të liberalizimit të vizave, megjithatë në bazë të deklaratës financiare të cilën e kemi të bashkangjitur në projektligj shohim se një pjesë e madhe e mjeteve për këtë projektligj janë të parapara gjatë 3 viteve të ardhshme. Do të jetë një ligj që njëkohësisht krijon edhe të hyra, megjithëse të hyrat nuk i kemi të detalizuara se sa mund të parashihet që të realizohen si dhe nuk është e paraparë në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Interesi ynë është të kuptojmë prej dy Ministrive se a mund projektligji, të parashihet në KASH 2013-2015 dhe a mund të bëhet pjesë e procesit buxhetor për vitin 2013, në mënyrë që të kemi një garancë se ligji do të jetë i zbatueshëm.

Bajram Rexhepi çështja e letërnjoftimeve biometrike, deri vonë ka qenë më tepër preferencë dhe jo domosdoshmëri e lidhur me procesin e liberalizimit të vizave, ndërsa me udhërrëfyesin zyrtar që e kemi pranuar është domosdoshmëri që të bëhet furnizimi i qytetarëve me letërnjoftime biometrike, dhe kjo është arsyeja që e kemi futur në procedurë të shpejtuar. Përveç rëndësisë që ka në procesin e liberalizimit të vizave është edhe parakusht për lëvizjen e lirë me shtetet fqinjë vetëm me letërnjoftim biometrik. Ne sot i kemi edhe dëgjimet buxhetore edhe kërkesat shtesë në Ministrinë e Financave, aty duhet të gjindet zgjidhja për arsye se ne sa marrim nga buxheti e kthejmë 2-3 herë më shumë. Ne i kemi shqyrtuar edhe mundësitë e partneritetit publiko-privat që edhe letërnjoftimet biometrike, pasaporta edhe patentë shoferat edhe librezat e qarkullimit të gjitha dokumentet personale të shkojnë me këtë llojë implementimi.

Ramadan Avdiu aprovimi i këtij ligji është imperativ dhe meqenëse jemi në fazën praktikisht finale të përgatitjes së buxhetit për vitin 2013 dhe ku të rishikohet edhe korniza afatmesme e shpenzimeve domosdoshmërisht do të duhet që këto implikime buxhetore që i sjell aprovimi i këtij ligji të përfshihen edhe në KASH për vitin 2013-2016.

Muhamet Mustafa mendoj se duhet ta kalojmë këtë ligj në leximin e dytë dhe të kërkojmë nga Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme t'i fusin gjërat në buxhetin e ardhshëm, ajo që është e domosdoshme. Sa i përket idesë së Ministrit lidhur me eventualisht partneritetin publiko-privat ato janë që Ministria mund ta bëjë një projekt për atë punë dhe pas të analizohet projekti, përparësitë dhe të metat, sigurisht jemi të gatshëm për propozime të mira në atë drejtim me i mbështet, në veçanti ato projekte që analizojnë kosto-benefitin e implementimit të tyre.

Bajram Rexhepi Ministria do ta bëjë edhe shpjegimin e duhur, edhe në fazën e përgatitjes së KASH-it edhe me i gjetur mjetet, ndërsa çështja pas elaborimit tonë se cila metodë do të jetë a me koncesion a me formën klasike me tender, janë çështje që sigurisht do të mundohemi të analizojmë metodën e kosto-benefitin që të kemi shërbime më të mira.

Sali Asllanaj, m ua po më krijohet përshtypja që në mungesë të buxhetit duhet të shkojmë në partneritet publiko-privat, kjo mos të jetë arsyeja. Le të bëhet një studim për aplikimin e kësaj metode dhe jo pse na mungojnë pak mjete hajde të shkojmë në partneritet publiko-privat, sepse ne jemi të predisponuar në Kosovë për abuzim me ligjin.

Albana Fetoshi pyeti a është paraparë metoda e partneriteti publiko-privat në projektligji?

Bajram Rexhepi, ideja për partneritet publiko-privat nuk është vetëm për letërnjoftime biometrike por me këtë mendojmë që të futemi edhe për pasaportat dhe çdo dokument tjetër personal, për atë arsye mendojmë që kur të vijmë pajisjet me qenë universale edhe të çështjeve të njëjta.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji nr. 04/L-126 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011

Kryetarja gjatë vitit 2011 buxheti i institucionit të avokatit të popullit është shpenzuar 87.34%. Për kategoritë e shpenzimeve në materialin e marrë nuk kemi ndonjë detalizim të shpenzimeve sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike, përpos të shpenzimeve komunale që i kemi të paraqitura. Po ashtu në raport paraqiten shënime rreth donacioneve të cilat i ka shfrytëzuar gjatë vitit 2011.

Sami Kurteshi njoftoi se kanë sjellur me vete një tabelë më të detalizuar të shpenzimeve. Të flitet saktësisht për të gjitha gjërat mendoj që është shumë por në raportin tone vjetor kemi shprehur brengat tona, kemi shprehur edhe kërkesat tona edhe kemi nxjerr raportin financiar ashtu si është shpenzuar. Ne e kemi pasur parasysh raportin e auditorit, e kemi marr bashkë me reagimet tona.

Hykmete Bajrami unë mendoj që kjo është çështje e raportit të auditorit të përgjithshëm se sa dhe si janë shpenzuar mjetet, por në fakt jam shumë e shqetësuar me ndërhyrjet që janë bërë nga Ministria e Financave në buxhetin e avokatit të popullit gjithashtu shpreh edhe indinjatën time të thellë që nuk po bëhet zbatimi i ligjit për rrogat e zv/avokatëve, në këtë rast unë kam vetëm mbështetje dhe inkurajim për punën e avokatit të popullit.

Latif Gashi pyeti pse raporti nuk është sjellur në kuvend brenda afatit të paraparë me ligj? Pastaj institucioni ka planifikuar mjetet për kategorinë e shpenzimeve komunale rreth 44 000 euro ndërsa janë shpenzuar vetëm 12 000 euro, një sqarim?

Xhevdet Neziraj theksoi se te pagat dhe mëditjet janë shpenzuar 86% e kanë realizuar buxhetin ndërsa janë kërkuar mjete për pagat e zv/avokatët dhe pse nuk i kanë marr nga kjo pjesë dhe ishte realizuar buxheti 100 %.

Kryetarja theksoi se nuk jemi të interesuar të bëjmë politik në lidhje me çështjen e pagave të zv/avokatëve të popullit sepse është një çështje që është diskutuar me dhjetëra herë në komisionin dhe nuk kemi pasur mundësi të bëjmë ndonjë zgjidhje në mungesë të ligjeve dhe në problematikën në të cilën jemi përballur. Unë jam plotësisht e bindur se të gjithë anëtarët e komisionit pa dallim partie politike apo pozicioni kemi qenë të interesuar që avokati dhe zv/avokatët e popullit të kenë paga të dinjitetshme, megjithatë kemi ardhur në deri në këtë pozicion që jemi. Me qenë se në raport shkruan se avokati i popullit nuk është ftuar nga komisioni për buxhet dhe financa për të dhënë arsyetimet në lidhje me buxhetin e vitit 2011. Ju e dini shumë mirë se buxhetin e vitit 2011 e kemi miratuar në fund të muajit mars dhe kemi pasur afat shumë të shkurtër për t'a diskutuar më në detale buxhetin dhe kërkesat buxhetore për vitin 2011, megjithatë unë si kryetare e komisionit për buxhet, e kam ftuar avokatin e popullit në zyrën time ku ka qenë prezent edhe koordinatori i komisionit dhe ftesës iu ka përgjigjur drejtori ekzekutiv i avokatit të popullit. Bashkë me drejtorin ekzekutiv i kemi analizuar kërkesat e IAP dhe kemi marr informatën se ky institucion nuk e ka dorëzuar kërkesën

buxhetore në Ministrinë e Financave siq kërkohet sipas ligjit dhe Ministria e Financave për shkak të mos pjesëmarrjes në dëgjimet buxhetore, e ka vënë të njëjtin buxhet për këtë institucion siq ka qenë në vitin 2010. Kemi ardhur në përfundim që për katër zv/avokatët e popullit është e paraparë paga dhe për një zv/avokat nuk ka qenë e paraparë paga sepse ligji i avokatit të popullit është aprovuar me vonesë. Komisioni ka përllogaritur pagën dhe mendimi i komisionit ka qenë që të shtohen buxhet në emër të ngritjes së pagës për 30%. Nuk kuptoj pse këta pesë zv/avokatëve e popullit nuk janë paguar sipas Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës? Dëshiroj që avokati i popullit të jetë institucioni më i papolitizuar dhe institucioni më i pranueshëm tek qytetarët e Republikës së Kosovës sepse vet pozicioni e përcakton pozicionin e tillë dhe në anën tjetër do të doja sidomos nga ana e avokatit të popullit që raportet të paraqiten në mënyrë jotendencioze.

Sami Kurteshit njoftoi se raporti është vonuar 3 muaj pikërisht për shkak të problemeve që i kemi pasur. Institucioni i Avokatit të Popullit nuk i ka paraqitur kërkesat në Ministrinë e Financave sepse konsideron që nuk është thirrur në kohë dhe nuk është konsultuar edhe për shpenzimet komunale janë llogaritur mjetet pa u konsultuar. Ne i kemi prezantuar shpenzimet siq kanë ndodhur dhe ku kemi mundur të kursejmë e kemi bërë. IAP në krejt takimet që ftohet i merr shumë seriozisht. Ne e kemi bërë raportin ashtu siq është paraparë me ligj dhe i'a kemi dërguar Kuvendit. Nuk është bërë konsultimi, ato mjete që i kemi marr ne i kemi kthyer përsëri.

Jashar Kastrati sqaroi se Zv/avokatëve janë zgjedhur në muajin tetor 2011 kurse kërkesa buxhetore dhe ndarja e buxhetit për paga ka qenë, prej muajit Janar - dhjetor 2011 dhe nuk janë ekzekutuar pagat për zv avokatit të popullit për shkak se IAP ka kërkuar që pagat e tyre të paguhen me nivel me pagat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, është nxjerr vendimi mirëpo nuk është ekzekutuar vendimi nga ana e Ministrisë së Administratës Publike.

Kryetarja për çfarë arsye ju i keni thenë zv/avokatëve që pagat e juaja janë të paligjshme? Mjetet kanë qenë të parapara me ligjin për buxhetin në vitin 2011.

Sami Kurteshi çështja e pagave të avokatit të popullit dhe zv/avokatëve është e pazgjidhur, dhe mënyra e pagesës është e kundërligjshme. Këtë ta keni të qartë.

Kryetarja ju mund të gjuani se pagat nuk janë të dinjitetshme se janë paga të ulëta dhe meritojnë paga më të larta por të thuash se janë paga të paligjshme kjo nuk është logjike.

Sami Kurteshi pagat janë të rregulluara me një ligj që nuk ekziston, në një shtet ligjor nuk mund të rregullohen ligje që nuk ekzistojnë. Qështja e pagave është e pazgjidhur.

Latif Gashi në cilën bazë ligjore kërkoni ju me zbatuar për të zgjidhur problemin e zv/avokatëve? A duhet të pritët ligji që vetëm e kemi në dorë për pagat e funksionarëve të lartë, dhe nuk e di ju si avokat a jeni konsultuar për ti dhënë rekomandimet e juaja në administratën publike në lidhje me pagat? apo jeni me vonesë edhe këtu? A jeni të kënaqur tash me trajtimin që po bëhet me ligjin e ri?

Sami Kurteshi gjërat rregullohen në një shtet ligjor me një ligj, ligji mund të jetë i vjetër, ne kemi ligje të krahinës autosocialiste autonome të Kosovës që sot janë në fuqi për arsye se ky shtet nuk ishte në gjendje të nxjerr ligje që i zëvendëson ato. Kjo është fatkeqësia jonë, prandaj nuk duhet të pritët por duhet të zbatohet ligji ekzistues.

Kryetarja kur të diskutojmë projektligjin mund të flasim për këtë tema. Ligji që ka rënë nga fuqia nuk di si mund të zbatohet ai.

Sali Asllanaj unë mendoj se po e banalizojmë këtë punë dhe pak ka tensionimeve partiake këtu. Unë kam pasur shumë mirëkuptim për kërkesën e rregullimit të çështjes së pagave. Duhet ta zgjidhim këtë problem. Si ti ndajnë këto rroga? Prandaj duhet të bëjmë maksimumin me projektligjin që është në procedurë që ta zgjidhim problemin e avokatit të popullit. Unë mendoj se raporti i tyre është mjaft i mirë dhe do duhej të miratohet.

Hykmete Bajrami theksoi se nuk kemi qenë asnjëherë korrekt me këtë institucion Qfarë baze ligjore ne kemi pasur që t'ia caktojmë shefit agjencisë për mbrojtjen e të dhënave pagën në nivel të pagës së deputetit? Ne e kemi pasur një reference dhe sa here kemi caktuar paga për agjensionet e pavarura ne e kemi marr si referencë pagën e deputetit. Këta e kanë pasur reference me gjyqtarët e gjykatës supreme e ne nuk ishim korrekt. Këta janë viktimitë e vullnetit politik.

Latif Gashi Mendojë që arsye që Ministria dhe Kuvendi nuk kanë mundur të vendosin për pagat e avokatit dhe zëvendësve të tij është për shkak të mungesë ligjore. Nuk do të mund të thirremi në një dokument ligjor që është shfuqizuar.

Kryetarja sqaroi se çështja e ligjit të avokatit të popullit dhe çështja e pagave të zyrtarëve të lartë ka qenë çështje e komisioneve tjera dhe jo çështje e komisionit për buxhet. Kuvendi e ka miratuar ligjin dhe unë them me përgjegjësi të plotë se nuk ka bërë mirë që e ka miratuar ligjin para se të miratohet ligji tjetër edhe të bazohet në pagat e zyrtarëve të lart publik. Ne na ka sjell probleme dhe vështirësi të mëdha. Ndoshta kemi bërë gabime, e drejta është në kuadër të secilit nëse realizohet ajo çka është kërkuar dhe gjendet baza atëherë janë edhe çështje që mund të bëhen kompenzime.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimin e Raportit vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-066 për Procedurën Kontestimore, me Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion

Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji nr.04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-066 për Procedurën Kontestimore nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-85 për Bujqësinë Organike, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji nr.04/L-85 për Bujqësinë Organike dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-90 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji nr.04/L-90 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Shqyrtimi i Projektregullorës së Kuvendit të Republikës së Kosovës me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion

Kryetarja, theksoi se sot nuk mund t'i shqyrtojmë implikimet buxhetore të kësaj çështje sepse nuk i është bërë ndonjë analizë financiare projektregullore prandaj nëse pajtoheni edhe ju e kishim shtyer për një takim tjetër.

Pas propozimit, Komisioni njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

Shtyhet shqyrtimi i Projektregullorës së Kuvendit të Republikës së Kosovës me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, në një mbledhje tjetër të komisionit.

10. Të ndryshme

Në këtë pikë u diskutua për organizimin e dëgjimeve buxhetore në Ministrinë e Financave dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të komisioneve në këto dëgjime. U vendos që me rastin e dëgjimit buxhetor të buxhetit të Kuvendit të marrin pjesë: Hykmete Bajrami dhe Latif Gashi.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ